

POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE¹

Përmbajtja

Pozicioni investimeve ndërkombëtare 1

Pozicioni i investimeve ndërkombëtare sipas sektorëve 2

Pozicioni i investimeve ndërkombëtare sipas instrumentave 2

Burimet e ndryshimeve në pozicionin e investimeve 3


Shënime shpjeguese 4

Kryesore:

- Niveli i zotërimeve të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare në fund të shtatorit 2024 shënon 13,067 milionë euro;
- Zotërimet e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare rezultojnë rreth 736.5 milionë euro më shumë referuar nivelit në fund të T2 2024;
- Niveli i detyrimeve ndaj jorezidentëve u zgjerua me 446.1 milionë euro, dhe shënon 23,311 milionë euro;
- Detyrimet në formën “Investime direkte” (kapitali dhe huadhënia ndër kompani) u zgjeruan me 550 milionë euro në nivelin 14,926 milionë euro;
- Transaksioni ka ndikuar pozitivisht në të gjitha format e investimit në mjete, si dhe investimet direkte në detyrime.

Në fund të muajit Shtator 2024, niveli i zotërimeve të Shqipërisë jashtë dhe ai i detyrimeve ndaj jorezidentëve shënojnë përkatësisht 13,067 milionë euro dhe 23,311 milionë euro. Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare Neto (PINN), i përcaktuar si diferenca midis zotërimeve (mjeteve) të Shqipërisë jashtë vendit dhe detyrimeve ndaj jorezidentëve shënoi -10,244 milionë euro, duke reflektuar ngushtim të pozicionit negativ prej 290.4 milionë euro krahasuar me fundin e T2 2024 (Grafiku 1 në të majtë).

Transaksioni rezultoi në efekt ngushtues të PINN, me rreth 401.1 milionë euro. Në të njëjtën kohë, efekti neto i ndryshimeve në kursin e këmbimit diktoi rritje të PINN të shprehur në monedhën europiane (me ndikim neto 206.2 milionë euro). Nga ana tjetër, ndryshimet në çmime dhe ndryshime të tjera, rezultuan me efekt ngushtues të pozicionit negativ të PINN, respektivisht me 61.5 milionë euro dhe 33.9 milionë euro.



Grafiku 1: Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare

Për informacione më të hollësishme mbi transaksionet shihni Njoftimin Statistikor të Bilancit të Pagesave. Gjatë T3 2024, zhvillimet në llogarinë financiare, të cilat rezultuan në ngushtim të pozicionit neto negativ të PINN, reflektojnë kryesisht (i) zgjerim të mjeteve të rezervës, (ii) flukse neto dalëse në investimet e tjera dhe investimet e portofolit, si dhe në të njëjtën kohë (iii) zgjerim të detyrimeve neto në formën e investimeve direkte.

Në ecurinë e tepricës së PINN, efekti neto i përllogaritur i zhvlerësimit të monedhës evropiane kundrejt monedhave përbërëse të emërimit të detyrimeve dhe zotërimeve të Shqipërisë ndaj botës ndikoi në zgjerim të detyrimeve. Sa i takon ndryshimeve në çmime të instrumentave financiare, ato i atribuohen kryesisht ndryshimeve në çmimin e arit dhe ndryshimeve në çmimin e letrave me vlerë të borxhit në investimet e portofolit, në kahun e mjeteve.


	Milionë EUR	
	Mjete	Detyrime
Investime direkte	2,170	14,926
Investime portofoli	2,649	1,533
Investime të tjera	2,386	6,852
Mjetet e rezervës	5,862	
Totali	13,067	23,311

Tabela 1: Mjetet dhe detyrimet sipas instrumenteve

¹ Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare është një pasqyrë statistikore që tregon vlerën dhe përbërjen e stokut të mjeteve dhe detyrimeve financiare të rezidentëve të një ekonomie me jorezidentët e një ekonomie tjetër, në një moment të dhënë në kohë.

POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE SIPAS SEKTORËVE

Ecuria e PINN sipas sektorëve institucionalë (Grafiku 2 dhe Tabela 2) vëren zgjerim, në terma tremujorë të balancës pozitive të *Bankës Qendrore (Autoriteti Monetar)*, pasqyruar në rritje të mjeteve të rezervës. Në të njëjtën kohë, *Qeveria e Përgjithshme* ngushtoi pozicionin debitor, në nivelin -4,616 milionë euro, kryesisht për rezultat të shlyerjes së detyrimeve në formën e “huasë” si dhe uljes së ekspozimit në “letra me vlerë të borxhit” ndaj jorezidentëve. Sektorët e Tjerë zgjeruan pozicionin debitor, në nivelin -12,672 milionë euro, në reflektim të zgjerimit të detyrimeve në investime direkte dhe investime të tjera. Korporatat Depozituese kanë zgjeruar balancën pozitive, kryesisht pasojë e zgjerimit të zotërimeve në “monedha dhe depozita” si dhe “letra me vlerë të borxhit” të emetuara nga jorezidentët.



Grafik 2: Struktura e PIN

	30 Qershor 2024		30 Shtator 2024	
	Milionë EUR	%	Milionë EUR	%
Qeveria e Përgjithshme	-4,739	20%	-4,616	19%
Banka Qendrore	5,292	22%	5,642	23%
Korporata Depozituese, me pënjashim të Bankës Qendrore	1,261	5%	1,402	6%
Sektorë të Tjerë	-12,348	52%	-12,672	52%
Totali	-10,534	100%	-10,244	100%

Tabela 2: PINN sipas sektorëve

Detyrimet e Shqipërisë janë ngushtuar kryesisht në reflektim të zgjerimit të mjeteve të rezervës

POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE SIPAS INSTRUMENTEVE

Analiza e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare në lidhje me instrumentet përfaqësues në zotërimet (mjetet) e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare, mbeti pothuajse e njëjtë me atë të T2 2024 (Grafiku 3). Mjetet e rezervës mbizotëruan më tej, me rreth 45% të totalit, e ndjekur nga investimet e portofolit, me një pjesëmarrje 20% të totalit. Investimet e tjera përbëjnë 18% të totalit të mjeteve, ndërsa investimet direkte përbëjnë rreth 17% të totalit të mjeteve.

Rezerva Ndërkombëtare e Shqipërisë (mjetet e rezervës) vijon të jetë komponenti kryesor i zotërimeve. Gjatë T2 2024, ato u zgjeruan me rreth 344 milionë euro - ndikuar kryesisht për blerjen e valutës dhe rivlerësimin pozitiv të instrumenteve në përmbajtje të portofolit të rezervës valutore, dhe në fund të shtatorit 2024 shënojnë 5,862 milionë euro. Ky nivel është i mjaftueshëm për mbulimin e 6.7 muaj importe mesatare në mallra dhe shërbime dhe rreth 492% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Investimet e portofolit u zgjeruan me 105 milionë euro, në nivelin 2,649 milionë euro. Në masën 99% ato përfaqësohen nga zotërimet e sektorit të Korporatave Depozituese (bankat) në tituj të borxhit të jorezidentëve. Gjatë tremujorit, bankat kanë zgjeruar zotërimet e tyre në formën e “letrave me vlerë të borxhit” të emetuara nga jorezidentët.


Investimet e tjera u rritën me 213 milionë euro dhe në fund të shtatorit 2024 shënuan 2,386 milionë euro. Sektorit i Korporatave Depozituese ka rritur vendosjet në “monedha dhe depozita”. Rreth 69% e vlerës së investimeve të tjera përfaqësohet nga “monedha dhe depozita” dhe pjesa tjetër kryesisht nga “hua” akorduar njësive jorezidente.

Në anën e detyrimeve, instrumentet përcaktues vijojnë investimet direkte dhe investimet e tjera, respektivisht me 64% dhe 29% të totalit.

Në fund të shtatorit 2024, teprica e detyrimeve në formën e investimeve direkte shënon 14,926 milionë euro nga 14,376 milionë euro, në fund të qershor 2024. Transaksioni në drejtim të zgjerimit të kapitalit ishte pozitiv, në rreth 560 milionë euro, ndërkohë janë ngushtuar detyrimet borxh krijuese brenda kategorisë së investimit direkt - marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura në një marrëdhënie investimi direkt - me rreth 10 milionë euro.



Detyrimet në formën e investimeve të tjera u ngushtuan me 84 milionë euro, në nivelin 6,852 milionë euro. Kjo ecuri i atribuohet kryesisht shlyerjes së detyrimeve në formën e “huasë” të Qeverisë së Përgjithshme. Sektori i Korporatave Depozituese ka rritur detyrimet në “monedha dhe depozita”, dhe Sektorët e Tjerë (korporatat jofinanciare) kanë ulur detyrimet e tyre në “kredi tregtare dhe paradhënie”. Në masën 49%, investimet e tjera përfaqësohen nga “hua” të marra nga Qeveria e Përgjithshme.




Grafik 3: Struktura e mjeteve dhe detyrimeve

BURIMET E NDRYSHIMEVE NË POZICIONIN E INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE

Analizuar sëbashku, Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare dhe Bilanci i Pagesave, referuar marrëdhënies stok dhe fluks për instrumentet financiare gjatë periudhës 30 qershor 2023 – 30 shtator 2024, vërehet se ndryshimet nga transaksioni kanë ndikuar pozitivisht në të gjitha format e investimit në mjete dhe në investimet direkte në detyrime. Në të njëjtën kohë, transaksioni në detyrime ka qenë negativ në investimet e portofolit dhe investimet e tjera.

Grafiku në vijim shfaq kontributin e elementëve kryesorë, me ndikim në diferencën midis dy pozicioneve (referuar nivelit në ditën e fundit të muajit shtator 2024 ndaj atij të ditës së fundit të qershor 2024), në nivel të agreguar për çdo formë investimi, – duke identifikuar efektin e rrjedhur nga transaksioni (fluksi i paraqitur në bilancin e pagesave); efektin nga ndryshimi në kursin e këmbimit të valutave përbërëse dhe ndryshimet në çmime të instrumenteve, si dhe efektin në stok të ndryshimeve të tjera.



Grafik 4: Burimet e ndryshimeve në zërat kryesorë të mjeteve dhe detyrimeve të PIN (30 qershor 2024 – 30 shtator 2024)

Transaksioni ka ndikuar pozitivisht në të gjitha format e investimit në mjete, si dhe investimet direkte në detyrime



SHËNIME SHPJEGUESE

<p>Hyrje</p>	<p>Statistikat e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare paraqesin gjendjen e stokut të fundit të periudhës të pretendimeve dhe detyrimeve të huaja financiare të ekonomisë shqiptare. Të dhënat janë kompiluar në bazë neto, d.m.th ato iu përkasin zotërimeve të rezidentëve të Shqipërisë në mjete të huaja dhe zotërimeve të jorezidentëve në mjete në Shqipëri. Ashtu si statistikat e Bilancit të Pagesave dhe statistikat e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare bëjnë dallimin ndërmjet investimeve direkte, investimeve të portofolit, derivativëve financiarë, investimeve të tjera dhe mjeteve të rezervës. Si e tillë, tabela e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare identifikon ata elementë të bilancit të agreguar të Shqipërisë që tregojnë pretendimet dhe detyrimet financiare të rezidentëve të Shqipërisë ndaj jo-rezidentëve. Shifrat prezantohen në mënyrë që të kenë qëndrueshmëri me formatet e prezantimit ndërkombëtar. Informacioni është i disponueshëm për Fondin Monetar Ndërkombëtar (http://www.imf.org/external/index.html).</p>
<p>Standarte Statistike Ndërkombëtare</p>	<p>Statistikat e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare në Shqipëri janë kompiluar në përputhje me manualin e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare M6PB (2009), Guidën kompiluese sipas M6BP të Fondit Monetar Ndërkombëtar FMN, (2014) si dhe në Pozicionin e investimeve ndërkombëtare – një guidë për burimet e të dhënave të Fondit Monetar Ndërkombëtar, (2004). Ndjekja e këtyre standardeve siguron pajtueshmëri të të dhënave nga njëra anë dhe nga ana tjetër, konsistencë midis statistikave të borxhit, të Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare si dhe me Sistemin e Llogarive Kombëtare (SNA2008) dhe Sistemin e Llogarive Europiane (ESA2010). Të dhënat mbi pozicionin e investimeve ndërkombëtare janë një burim i rëndësishëm informacioni për zëra të caktuar të këtyre statistikave.)</p>
<p>Përkufizimi i Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare</p>	<p><i>Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare</i> është një pasqyrë statistikore që tregon vlerën dhe përbërjen e stokut të mjeteve dhe detyrimeve financiare të rezidentëve të një ekonomie me jorezidentët e një ekonomie tjetër, në një moment të dhënë në kohë. Ky stok është rezultat i transaksioneve me jorezidentët të vlerësuar me vlerën korrente të tregut, kurseve përkatëse të këmbimit, ndryshimeve në çmim dhe faktorëve të tjerë (falje, riklasifikime, etj) në një moment të caktuar. Pozicioni neto i pozicionit të investimeve ndërkombëtare tregon diferencën ndërmjet pretendimeve dhe detyrimeve të një ekonomie ndaj jorezidentëve. Ai mund të jetë pozitiv ose negativ. Pozicioni neto bashkë me stokun e mjeteve jofinanciare përfaqëson pasurinë e një ekonomie.</p>
<p>Rezidenca</p>	<p>Termi <i>rezident</i> iu dedikohet (a) individëve, përfshirë dhe atyre me kombësi të huaj, që jetojnë në Shqipëri për të paktën një vit ashtu si dhe stafit të ambasadës shqiptare dhe stafit ushtarak të vendosur jashtë, (b) trupave qeveritare shqiptare të vendosura jashtë (ambasadave, konsullatave, etj), dhe (c) korporatave që kanë në Shqipëri qendrën e interesit ekonomik, përfshirë dhe degë të kompanive të huaja të regjistruara. Gjithashtu përfshihen edhe sipërmarrjet me pronësi të huaj të vendosura në Shqipëri dhe të angazhuara në aktivitete të shërbimeve financiare të tregtuara në arenën ndërkombëtare.</p> <p><i>Jorezidentë</i> të një ekonomie përkufizohen njësitë institucionale që nuk janë rezidentë të asaj ekonomie.</p>
<p>Tipet e Instrumentave Financiarë të Rëndësishëm të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare</p>	<p>a- <i>investimet direkte</i> sipas M6BP dhe përkufizimit standard të OECD-së (Botimi 4) përcaktohen si kategoria e investimeve ndërkombëtare të lidhura me një rezident në një ekonomi, i cili ka kontroll ose një shkallë të caktuar influence në manaxhimin e një ndërmarrjeje, e cila është rezidente në një ekonomi tjetër. Investimet direkte kërkojnë që investitori direkt duhet të ketë një pronësi 10 përqind ose më shumë të aksioneve të zakonshme ose të fuqisë votuese në manaxhimin e një ndërmarrjeje</p> <p>b- <i>investimet e portofolit</i> përfshijnë investimet në kapital dhe në tituj borxhi. Në ndryshim nga investimet direkte, investitori për investimet në kapital duhet të zotërojë më pak se 10 përqind të aksioneve dhe në këtë mënyrë ai nuk zotëron ndonjë fuqi efektive në manaxhim.</p> <p>c- <i>derivativët financiarë</i> iu referohen instrumenteve financiare që janë të lidhur me një tjetër instrument financiar ose mall dhe nëpërmjet të cilëve risqe specifike financiare mund të transferohen dhe tregtohen në tregjet financiare.</p> <p>d- <i>investimet e tjera</i> përfaqësojnë një kategori që përfshin të gjitha transaksionet financiare që nuk janë të përfshira tek investimet direkte, investimet e portofolit ose mjetet e rezervës.</p>
<p>Mbledhja e të dhënave</p>	<p>Burim informacioni për statistikat e Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare janë: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Organizata e Institucione të tjera Ndërkombëtare si dhe sistemi bankar pjesë e Sistemit të Unifikuar të Raportimit në Bankën e Shqipërisë.</p>

<p>Vlerësimi</p>	<p>Stoku i mjeteve dhe detyrimeve është regjistruar në vlerë tregu ose në vlerë nominale. Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare të Shqipërisë është kompiluar në lekë dhe publikohet në euro. Për stokun e mjeteve dhe detyrimeve në monedha të tjera, konvertimi bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të datës së fundit të periudhës së raportimit. Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit është përfshirë në vlerësimin e stokut të detyrimeve. Instrumentet përkatës përfshijnë dhe interesat e përlogaritur në vlerën e stokut të tyre.</p>
<p>Paraqitja e tabelës</p>	<p>Paraqitja e të dhënave të Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare së pari dallon instrumentet financiarë:</p> <p><i>Instrumentet financiare:</i> kapitali, monedha dhe depozita, tituj borxhi, kredi tregtare (të pagueshme), detyrime të tjera borxhi, derivativë dhe alokimet në SDR.</p> <p><i>Sektorët institucionalë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> * Autoriteti monetar (Bankë Qendrore) * Korporata depozituese me përjashtim të Bankës Qendrore * Qeveria e përgjithshme * Sektorët e tjerë <p>Brenda sektorëve klasifikimet jepen sipas:</p> <p><i>maturitetit - afat-shkurtër:</i> në rastet e një maturimi origjinal një vit ose më pak;</p> <p><i>afat-gjatë:</i> për një maturim origjinal më shumë se një vit.</p>

DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,

Tel: +355 4 241 93 01
+355 4 241 93 02
+355 4 241 93 03
+355 4 241 94 09
+355 4 241 94 10
+355 4 241 94 11

Fax: +355 4 241 94 08



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihet përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në stokun e pozicionit të investimeve ndërkombëtare si pasojë e rishikimeve.

Për më shumë informacion mbi të dhënat e stokut të pozicionit të investimeve ndërkombëtare referojuni linkut të mëposhtëm:

*[https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/
Pozicioni_i_Investimeve_Nderkombetare_PIN/](https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Pozicioni_i_Investimeve_Nderkombetare_PIN/)*